



**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë**

**DEPARTAMENTI PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DECENTRALIZIM DHE  
KOMUNITETE  
Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik**

**Raporti Mujor –Prill 2007**

## **Dështimi në mirëmbajtjen e sistemit të përgjimit pengon hetimet e ndaj aktiviteteve të mundshme kriminale dhe mund të shkel ligjin vendor**

Departamenti për të Drejtat e Njeriut, Decentralizim dhe Komunitete, pranë OSBE-së Misioni në Kosovë është i shqetësuar që dështimi i autoriteteve në mirëmbajtjen e sistemit për përgjimin e telefonatave i cili është i paraparë me dispozitat e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK)<sup>1</sup> pengon hetimin e rregullt të krimeve serioze, dhe mund të shkel ligjin vendor.

Prokurorët janë përgjegjës për hetim dhe ndjekje të personave të cilët kryejnë vepra penale.<sup>2</sup> Prokurorët ndërkombëtarë shpesh herë merren me hetimin e rasteve më të ndjeshme, siç janë rastet që kanë të bëjnë me trafikim, krim të organizuar, krime lufte apo korrupsion.<sup>3</sup> Komiteti i Ministror i Këshillit të Evropës, rekomandon që autoritet publike “duhet të ndërmarrin masa efektive që u garantojnë prokurorëve publik mundësitë për ti përmbushur përgjegjësitë dhe detyrat e tyre në kushte adekuate ligjore dhe organizative. (...)”<sup>4</sup>

KPPP krijon mundësinë e masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit. Në veçanti, përgjimi i bisedave telefonike është një mjet i fuqishëm për autoritetet kompetente që të hetojnë dhe ndjekin krimin në mënyrë efektive. Si mbas KPPPK-së, “gjyqtari i procedurës paraprake me kërkesë të prokurorit publik mund të urdhërojë përgjimin e telekomunikimeve.”<sup>5</sup> Për më tepër, oficeri i autorizuar i policisë duhet të fillojë implementimin e urdhrat jo më vonë se 15 ditë nga dita e lëshimit të tij<sup>6</sup>.

Megjithatë, OSBE ka mësuar se që së paku nga muaji Tetor 2006 deri në fund të muajit janar 2007, për shkak problemeve teknike, prokurorët ndërkombëtarë nuk kanë mundur të bëjnë përgjimin e bisedave telefonike.<sup>7</sup> Në bazë të dokumenteve dhe intervistave me prokurorët ndërkombëtarë, kjo ka ndikuar negativisht në hetimin e disa rasteve të profilat të lartë (krim i organizuar, dhe raste të korrupsionit, etj.).

Me 31 Tetor 2006, Drejtoria e UNMIK-ut për Krim të Organizuar informoi prokurorët ndërkombëtarë për një “dështim serioz” në sistem, por nuk dha ndonjë hollësi për arsyet e dështimit. Vetëm shtoi se prishja ka prekur edhe media CD-në, që bën kontrollimin e të dhënave apo përgjimit<sup>8</sup>. Për shkak të këtyre vështirësive teknike, policia nuk ka mundur që brenda afatit të paraparë të zbatojë urdhrat e gjyqtarëve paraprak për të përgjuar telekomunikimet, gjë që mund të shkaktoj shkeljen e ligjit vendor.

---

<sup>1</sup> Nenet 256-257, Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale I Kosovës.

<sup>2</sup> Neni 46(1), KPPPK.

<sup>3</sup> Për një rishqyrtim të rrolit të prokurorëve ndërkombëtarë, shih Rregulloren e UNMIK-ut 2000/06 *Mbi Emërimin dhe Largimin nga Zyra, Gjykatësit dhe Prokurorët Ndërkombëtarë*, 15 Shkurt 2000, me ndryshimet sipas Rregulloreve të UNMIK-ut Nr. Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale I Kosovës. 2000/34 dhe 2001/02

<sup>4</sup> Këshilli i Evropës në *Rekomandimin rek(2000)19 të Komitetit Ministrorë të vendeve anëtare mbi rolin e prokurorëve në sistemin e drejtësisë penale*, 6 Tetor 2000, neni 4.

<sup>5</sup> Neni 258(2)

<sup>6</sup> Neni 260(1).

<sup>7</sup> Disa prokurorë vendorë kanë hasur në probleme të tilla në përgjimin e bisedav telefonike.

<sup>8</sup> Citat nga një dokument I të përmbajtur në dosjen hetimore të rastit, i cili ishte ndikuar kundër thënshëm nga rrënja e sistemit të përgjimit

Prishja e sistemit për përgjimin e thirrjeve telefonike ka penguar hetimet dhe ndjekjet e aktiviteteve të raportuara penale, pasi që prokurorët ndërkombëtarë nuk kanë mund të përdorin teknikat a fshehta hetimore. Autoritetet relevante mund të kenë shkelur ligjin vendor duke dështuar në mirëmbajtjen e sistemit të përgjimit i cili është i parashikuar me dispozitat në KPPPK, përkritazi me teknikat hetimore në dispozicion të prokurorëve.

Andaj, OSBE rekomandon që:

- Autoritete relevante, sikur se është Departamenti i Drejtësisë, Drejtoria për Krim të Organizuar, Shërbimi Policor i Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë, menjëherë të ndërmarrin të gjitha hapat e domosdoshme për të mirëmbajtur një sistem funksional të përgjimit ashtu që urdhri i gjyqtarit paraprak për përgjimin e telefonit të mund të ekzekutohet pa vonesë.

### **Vonesat në procedurë për shkak të mungesës së përsëritur të dëshmitarëve ekspert mund të shkel të drejtën në gjykimin brenda një kohe të arsyeshme**

OSBE është e shqetësuar që mungesat e përsëritura të dëshmitarëve ekspert gjatë gjykimeve civile shkaktojnë vonesën procedurës, që shkel ligjin vendor dhe mund të kontribuoj në shkeljen e të drejtës së individit për një gjykim brenda një kohe të arsyeshme.<sup>9</sup>

Përkritazi me emërimin e dëshmitarëve ekspert, sipas ligjit të aplikueshëm, “gjykata do të nxjerrë prova nga dëshmia e dëshmitarit ekspert në çfarëdo kohe me qëllim të përcaktimit apo sqarimit të një fakti ku njohuria eksperte është e nevojshme e të cilën gjykata nuk e posedon.”<sup>10</sup> Dëshmitari ekspert është i obliguar ti përgjigjet ftesës së gjykatës dhe të ofrojë gjetjet dhe mendimin e tij.<sup>11</sup> Për më tepër, gjykata mund të gjoboj dëshmitarin ekspert i cili nuk paraqitet në seancën kryesore, ndonëse i ftuar me rregull, dhe i cili nuk e arsyeton mungesën e tij.<sup>12</sup>

Me gjithat, OSBE ka vërejtur shkeljet e këtyre kërkesave ligjore në rastet në vijim:

Në një konflikt pronësorë përkritazi me vërtetimin e pronësisë në gjykatën komunale (...) me datën (...), gjykata urdhëroj me datën (...) që eksperti i gjeodezisë<sup>13</sup> të zhvillojë vlerësimin ekspert përkritazi me matjen e pronës se kontestueshme. Pas parashtrimit të raportit të ekspertit me datë (...), gjykata vendosi gjatë seancës gjyqësore të datës (...) sipas propozimit të paditësit, ta ftojë ekspertin e gjeodezisë për seancën e ardhshme për të sqaruar më tej raportin e ekspertit. Që nga atëherë gjykata ka shtyrë seancën kryesore gjashtë herë<sup>14</sup> për shkak të mungesës së dëshmitarit ekspert. Eksperti ka arsyetuar mungesën e tij vetëm një herë.<sup>15</sup>

<sup>9</sup> Neni 6(1) Konventa Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut.

<sup>10</sup> Neni 250, Ligji mbi Procedurën Kontestimore (LPK), RSFJ Gazeta Zyrtare 4/77-1478, 36/80-1182, 69/82-1956.

<sup>11</sup> Neni 253(1), LPK.

<sup>12</sup> Neni 255(1), LPK.

<sup>13</sup> Eksperti I Gjeodezisë ishte I punësuar nga Komuna (...)

<sup>14</sup> Gjykata ka shtyer seancën në datat (...)

<sup>15</sup> Për seancën e datës (...) eksperti informoi gjykatën përmes telefonit, për mos ardhjen e tij, për shkak të angazhimeve tjera në teren.

Në rastin e dytë të konfliktit pronësorë para gjykatës komunale në (...) që përfshinë padinë për ndërhyrje në posedim, gjykata ftoj ekspertin e gjeodezisë<sup>16</sup> për seancën gjyqësore me datë (...) për të shpjeguar raportin e tij ekspert. Ndonëse gjykata e ftoj në mënyrë të rregullt ekspertin, ai nuk u paraqit në seancë. Vetëm pasi që kryetari i trupit gjykues mori informata nga punëdhënësi i tij gjykata mësoi se eksperti, nuk ka mundur të marrë pjesë në procedurë pasi që ai ishte përndryshe i angazhuar në punën në teren. Rrjedhimisht gjykata e shtyri seancën.

Në të dy këto shembuj, vonesat do të mund të shmangeshin nëse dëshmitari ekspert do ti përmbahej ftesave gjyqësore. Si shqetësim, në këto raste ekspertët, si zyrtarë publik të punësuar nga komuna, kanë injoruar ftesat e një autoriteti tjetër publik, gjykatave komunale. Për më tepër, gjykatat nuk kanë përdorur masat ndëshkimore të lejuara nga ligji vendorë për të siguruar prezencën e dëshmitarëve ekspert në gjykime. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjatë vlerësimit të arsyes së kohëzgjatjes së procedurës, merë në konsideratë sjelljen a autoriteteve administrative dhe gjyqësore. Andaj, dështimi i të punësuarve komunal që veprojnë në kapacitetin e tyre si ekspert për tu përmbajtur ftesave gjyqësore dhe e gjykatave për të siguruar prezencën e ekspertëve mund të rezultojë në shkelje të së drejtës për gjykim brenda një kohe të arsyeshme.<sup>17</sup>

Rrjedhimisht, OSBE rekomandon që:

- Gjykatat të përdorin të gjitha masat e ofruara nga ligji i aplikueshëm për të siguruar prezencën e dëshmitarëve ekspert në gjykime.
- Autoritetet komunale duhet të sigurojnë që kur të ftohen, të punësuarit komunal ti përgjigjen ftesave të lëshuara nga gjykata dhe të marrin pjesë në seanca.

---

<sup>16</sup> Eksperti i Gjeodezisë ishte i punësuar nga Komuna (...)

<sup>17</sup> Shih *Fredlender v Francës*, nr.3079/96, Aktëgjykimi, 22 Dhjetorë 2005 paragrafi 33: shih gjithashtu *Dumanovski v IRJ e Maqedonisë*, nr. 13898/02, aktgjykimi 8 Dhjetorë 2005, paragrafi 40.